REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës:	2022:241525
Datë:	06.02.2023
Numri i dokumentit:	03942454

C-IV - 15- 1161

Paditës: B H nga P, të cilin e përfaqëson av G A nga P

Kundër

Të paditurës: Ndërmarrja Shoqërore ,, N G H sh " në likuidim të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, rr. ,,Driton Hoxha '' 55.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtarin Hasim Sogojeva, me 03 shkurt 2023, mori këtë :

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa/kërkesa e paditësit dhe ndryshohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit për NSH, ,, N G H sh '', PRN 173-0259, dt. 21.05.2015, obligohet e paditura NSH ,, N G H shpk'', që paditësit B H për diferencën e pagave të pa paguara, t' ia paguaj shumën 776.76€, për periudhën dt. 14.02.2007 deri më dt. 15.06.2011, sipas nenit 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

II. Secila palë i heqë shpenzimet e procedurës .

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 22 qershor 2015, pranë DHPGJS është parashtruar ankesa/ kërkesa e paditësit, kundër të paditurit në lidhje me Vendimin e Autoritetit Likuidues (AL) për NSH ,, N G H sh '' PRN 173 – 0259, dt. 21. 05. 2015, me të cilin është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit për kompensim e pagave të pa paguara, në shumën 776.76€

Paditësi në ankesë përmes të autorizuarit thekson se me të paditurën ka kontratë të punës, për periudhën e kërkesës kontestuese .

2022:241526

Komisioni i NSH N C G H, ka përpiluar raportin për pagat e pa paguara sipas kontratës së punës .

AKP-ja / AL në arsyetim të Vendimit me të cilin më është refuzuar kërkesa, është arsyetuar se kërkesat që rrjedhin nga marrëdhënia e punues parashkruhet për tri vite, por kjo nuk qëndron pasi afati i përgjegjshëm për parashkrim sipas nenit 371 të LMD-së, është pesë vjet.

Sa i përket pretendimit se nuk kam paraqitur asnjë provë që kërkesa është dorëzuar në gjykatë në afatin prej tri viteve kjo nuk është e arsyeshme sepse NSH është privatizuar në vitin 2007, me spinof special dhe NSH si ndërmarrje e menagjon AKP-ja. Unë dhe punëtoret tjetër i kemi kryer punët dhe detyrat e punës pa marrë parasysh ndërrimet e bëra në ndërmarrje , ndërsa pagat nuk i kemi marr.

Me shkresën e AKP-së, M T , dt. 07.08.2012, në kërkesën ton drejtuar AKP-së për pagimin e pagave na është thënë se ato do të shqyrtohen në mënyrë meritore nga AL .

Ne kërkesën në AKP, e kemi ushtruar më dt. 18.03.2015, brenda afatit ligjor .

Ka kërkuar të anulohet Vendimi i AKP-së dhe paditësit ti njohët kompensimi për paga të pa paguara në shumën 776.76 €.

Parashtresës ja ka bashkangjitur :

- Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, PRN 173 – 0259,
- Kopja e dokumentit identifikues,
- Kontrata e punës dt. 03.01.2007,
- Shkresa e dt. 20 02.2012, e punëtorëve drejtuar AKP-së në lidhje me pagat e pa paguara ,
- Njoftimi për AKP-në dhe drejtorin D A, dt. 26.03.2012,
- Përgjigja në shkresën e dt. 24.07.2012, e hartuar nga M T Zëvendës Drejtori e AKP-së, e protokolluar më dt. 07.08.2012,
- Vendimi i marr nga Sindikata e punëtorëve dt. 24.04.2012,
- Vendimi i Sindikatës 02.04.2012
- Llogaritja e pagave të pa paguara për periudhën dt. 14.02.2007 deri dt. 15.06.2011, nga Komisioni i të padituës dt. 11.11.2014 , në shumën 776.76 €
- Llogaritja e kontributit të pa paguar për periudhën e vitit 2010, 2011 dhe 2007, në shumën 459.67€ , dt. 11.11.2014.

Më dt. 22. 12. 2022, AKP- ja përmes përfaqësuesit ka paraqitur mbrojtjen e saj ndaj pretendimeve në ankesën/ kërkesën e paditësit, kundër Vendimit PRN 173 - 0259, për NSH ,, N G H sh ’’ me propozim që ankesa të refuzohet si e pa papranueshme dhe ose / të pa bazuar dhe të vërtetohet vendim i Autoritetit të Likuidimit .

AKP-ja, në parashtresë të mbrojtjes ka pohuar faktin se NSH ,, N G H sh ’’ ka hyrë në procedurë të likuidimit më dt.02.02.2015, ndërsa paditësi më dt. 18.03.2015, ka ushtruar kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara, në shumën 776.76€, për periudhën 14.02.2007 deri 15.06.2011.

2022:241526

Autoritetit i Likuidimit (AL) ka marrë Vendim PRN 137- 0259 , dt. 22.06.2015 me të cilin e ka refuzuar kërkesën e parashtruesit. AKP-ja , pretendon se Vendimi i AL është i bazuar në faktet dhe bazat ligjore si në vijim :

i) Neni 36.2 nën paragrafi 1, i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, për AKP-në, parashikon ,, elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme për refuzimin e kërkesës apo interesit të pretenduar të kapitalit apo interesit të pronësisë ... Kërkesa ose pretendimi është i pasafatëshëm nga kufizimet kohore të aplikueshme ’’ .

ii) Neni 608 i Ligjit për punën e bashkuar , parashikon se ,, pagesat e shumës së pagës apo rrogës , ose të ndonjë kërkese tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës , parashkruhet për tre vjet ’’ .

Në parashtresë ka bashkangjitur vendimin e AL PRN 173- 0259.

<u>Arsyetimi Ligjor</u>

Ankesa/Kërkesa e paditësit, është e bazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 398 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqës, ka konstatuar se nuk është si kontestues fakti se paditësi, ishte punëtor i të padituës NSH ,, N G H shpk ’’ në likuidim, në vendin e punës ,, Punëtor Sigurimi ’’, me pagë mujore 200.00€, kjo sipas provës së dokumentit të Kontratës së punës, dt. 03.01.2007.

Gjykata me provën e dokumentit dt. 11.11.2014, të Llogaritjes së pagave nga Komisioni i të padituës në përbërje prej : I R, M A, I B, L S, B H dhe A Z, ka vërtetuar faktin se për periudhën prej dt. 14.02.2007 deri më dt. 15.06.2011, për punëtorin B H është llogaritur diferenca e pagës së pa paguar në shumën 776.76€. Kjo diferencë është llogaritur duke marrë për bazë lartësinë e pagës, dhe pjesa e pagës së pa paguar.

Komisioni në fjalë ka llogaritur edhe diferencën e kontributit që punëtorit nuk ju është paguar për periudhën e vitit 2007, 2010 dhe 2011, në shumën 459.67€, por kjo kërkesë nuk është lëndë e ankesës.

Gjykata me provën kërkesës së punëtorëve drejtuar AKP-së, dt. 20.02.2012, vërtetohet fakti se punëtoret i kanë kërkuar pagesat e pagave te AKP.

Po ashtu dhe me dokumentin njoftim të lëshuar nga Sindikata e punëtorëve për AKP-në dt. 26.03.2012, vërtetohet se Sindikata ju ka drejtuare AKP-së, në lidhje me mos pagesat e pagave nga privatizuesi.

Me provën e përgjigjes dt. 07.08.2012, e lëshuar nga AKP, Zëvendës drejtori M T, vërtetohet fakti se AKP, ka qenë e njoftuar me situatën e mos pagesës së pagave për punëtoret e NSH, së, sikundër që me këtë njoftim punëtorëve ju është premtuar se pagat e pa paguara do të shqyrtohen në procedurë të likuidimit .

2022:241526

Gjykata vlerëson se këto prova i ka edhe e paditura, dhe e paditura në përgjigje në mbrojte nuk është deklaruar në lidhje me këto prova, por vetëm është deklaruar se kërkesa është parashkruar, përkundër faktit që punëtoret në vazhdimësi kanë kërkuar pagimin e pagave te AKP-ja , dhe AKP-ja ka premtuar se për kërkesat e tyre do të vendosen meritorisht .

Gjykata vlerëson se me dokumentin përgjigje e dt. 07.08.2012, AKP nuk është thirr fare në parashkrim të kërkesës, por vetëm se kërkesat në paga do të shqyrtohen apo që punëtoret të udhëzohen në inicimin e kontestit civil për pagimin e pagave .

Gjykata vlerëson se përgjigja e AKP-së, dt. 07.08.2012, si dhe Llogaritja e diferencës së pagave të pa paguara nga Komisioni i të paditurës dt. 11.11.2014, janë veprime me të cilat është pohuar borxhi për paga të pa paguara sipas nenit 387 të LMD-së së RSFJ, gjegjësisht nenit 368 të LMD , Ligji nr. 04/L-077, me këto veprime është ndërprerë parashkrimi, si nga AKP, ashtu edhe nga Komisioni i të paditurës , gjegjësisht rrjedhja e parashkrimit është pezulluar, për shkak se janë pritur procedurat për fillimin e likuidimit nga AKP, ndaj NSH .

Me Vendimin e AL PRN 137- 0259, është refuzuar kërkesa e me të cilën kërkohet kompensimi i pagave të pa paguara në shumën 776.76€, për periudhën dt. 14.02.2007 deri dt. 15.06.2011, duke u mbështetur në nenin 36.2.1, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Gjykata vlerëson se paditësi sipas barrës së provës ka vërtetuar faktin se gjatë periudhës kontestuese atij nuk ju është paguar paga në tërësi , dhe se me llogaritjen e diferencës së pagave të pa paguara për periudhën 14.02.2007 deri më dt. 15.06.2011, atij ju është mbetur borxh në shumën 776.76€.

Gjykata pas konstatimit të kësaj gjendje faktike, e cila ndryshon nga gjendja faktike e konstatuar nga AKP-ja, vlerëson se si pasoj e konstatimit të gabuar të gjendjes faktike nga AKP-ja edhe është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta materiale, kur me Vendim është refuzuar kërkesa e paditësit nga baza e parashkrimit .

Gjykata vlerëson se kërkesa e paditësit nuk është parashkruar, ashtu që e paditura me asnjë fakte nuk e ka provuar pretendimin e saj për parashkrimin e kërkesë së paditësit .

Me nenin 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 është paraparë ,, Kërkesat e pasiguruara , përfshirë , kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritetin më të lartë ’’ .

Meqenëse Gjykata, ka vërtetuar një gjendje tjetër faktike si më lartë në bazë të provave të dorëzuara nga palët ndërgjyqës dhe pretendimeve të tyre në lidhje me parashkrimin nga ajo që është vërtetuar nga Autoriteti i Likuidimit me Vendim të ankimuar, Gjykata vendosi që Vendimi PRN 137 - 0259, dt. 21.05.2015 të ndryshohet dhe ta pranoi ankesën/ kërkesën , duke vendosur si në dispozitiv .

Gjykata me rastin e pranimit të kërkesës së paditësit, ka zbatuar dispozitën e nenit 40 paragrafi 1, pika 7 të Shtojcës së Ligjit, nr. 04/L-034 .

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe juridike në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

2022:241526

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, u vendos që secila palë ti heq shpenzimet e veta të procedurës .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva

Gjyqtar